



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.9.2023

Nr: 783

Ora: 16:30

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË ORGANIZATËS “QËNDRESA QYTETARE”, PËR
NDALIM TË AKTIVITETIT TË KANDIDATIT TË “PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, Z. ALBERT
HALILAJ, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR
2023**

Sot, më datë 20.9.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Organizata “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”
z. Albert Halilaj, kandidat për Kryetar të Bashkisë Kukës

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare” për ndalim të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Albert Halilaj, për shkelje të parashikuara në nenin 78, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronja “n”, neni 78, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në datën 19.9.2023, në e-mail-in zyrtar të faqes së denoncimeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është dërguar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” kërkesë për ndalim të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, z. Albert Halilaj.

Objekti kryesor i kësaj kërkesë është ndalimi i zhvillimit të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Albert Halilaj, koncert festiv me pjesëmarrje këngëtarësh, i

Data: 20.9.2023 Nr: 783
Ora: 16:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”, për ndalim të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023

planifikuar për t'u organizuar në datën 20.9.2023, në sheshin "Skëndërbej" Kukës, ora 18:30, nga "Partia Socialiste e Shqipërisë" dhe kandidati i saj për këtë bashki.

Organizata "Qëndresa Qytetare" raporton për shkelje të pikës 9, të nenit 78, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, që përcakton se: "Subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve u ndalohej të organizojnë, kryejnë apo mbulojnë shpenzimet vetë ose nëpërmjet të tretëve për koncerte, shfaqje kulturore argëtuese apo veprimtari bamirësie, pavarësisht nëse ato mbahen përgjatë ose në lidhje me tubimet elektorale, apo zhvillohen si veprimtari fushate ose jashtë saj".

Në përgjigje të këtij denoncimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve filloi hetimin administrativ. Në kuadër të këtij hetimi, nëpërmjet postës elektronike e-mail, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftoi palët e përfshira në këtë proces, për zhvillimin e seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ditën e mërkurë, datë 20.9.2023 ora 16:30, dhe u kërkoi informacion sqarues në lidhje me këtë çështje.

Në seancën publike të zhvilluar, u paraqit përfaqësuesi i Organizatës "Qëndresa Qytetare".

Subjekti Zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", nëpërmjet shkresës së Sekretarit për Çështje Zgjedhore, z. Eridian Salianji, me nr. extra prot., datë 20.9.2023, administruar nga KQZ me nr. 6942/1 prot., datë 20.9.2023, me lëndë "Kthim përgjigje", ka bërë me dijeni se:

"Jemi njohur me shkresën tuaj nr. 6942 prot., datë 20.9.2023, lidhur me aktivitetin, koncert që do të zhvillohej sot, në datë 20.9.2023, ora 18:30, në Bashkinë Kukës nga ana e PS dhe kandidati z. Albert Halilaj. Ju bëjmë me dije se Partia Socialiste dhe kandidati i saj, z. Albert Halilaj, nuk organizon dhe nuk zhvillon sot koncertin në qytetin e Kukësit".

Z. Albert Halilaj, kandidat për Kryetar të Bashkisë Kukës, ka kthyer përgjigje nëpërmjet postës elektronike, të datës 20.9.2023, ku bën me dijeni se:

"Pasi jam njohur me shkresën tuaj nr. 6942 prot., datë 20.9.2023 përsa i përket koncertit që do të zhvillohet sot, në Bashkinë Kukës, Ju bëj me dije se unë, si kandidat për Kryetar Bashkie i "Partisë Socialiste" nuk organizoj dhe zhvilloj koncertin sot në qytetin e Kukësit".

Në seancën e zhvilluar, përfaqësuesi i Organizatës "Qëndresa Qytetare" konstatoi se postimi i kryer nga ana e kandidatit të Partisë Socialiste z. Albert Halilaj, nuk është më në faqen e tij zyrtare në Facebook.

Nga analiza ligjore, pas verifikimit të të dhënave, provave dhe fakteve të administruara vlerësojmë se, në kushtet kur subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" dhe kandidati i saj për Kryetar Bashkie, z. Albert Halilaj angazhohen për respektimin e dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor dhe marrjen e masave për mos të zhvilluar aktivitetin e planifikuar, nuk gjendemi para kryerjes së shkeljes administrative, sipas nenit 78, pika 9 të Kodit Zgjedhor. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të monitorojë në vijimësi si do të procedojnë subjektet zgjedhore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, dhe nenin 78, pika 9, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” dhe kandidatit të saj, z. Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim do t’u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI